



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 13

Prishtinë, më 29.04.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Valdete Bajrami, Etem Arifi dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Teuta Haxhiu dhe Slavko Simiq.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit UNICEF.

I ftuar: Besim Kajtazi-Zyra e Kryeministrit.

Pjesëmarrës të tjerë: Faton Hamiti-Kuvendi i Kosovës, Floreta Kabashi-Kuvendi i Kosovës, Liridona Fetahu-ZKM, Flurije Morina-ZKM, Egzona Boshnjaku-ZKM, Alberita Hyseni-ZKM, Selvete Gergjaliu-GDNJD, Teuta Hoxha-YIHR KS, Edona Tolaj-YIHR KS, Ukë Gashi-ZRPK, Lejla Selimi-OSBE, Valmire Hoti-Infodirekt, Visar Bivolaku-EUOR dhe Arta Xhylani- Praktikante e Kuvendit të Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve nr. 11 dhe nr. 12;

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Barazi Gjinore;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
5. Shqyrtimi i Peticionit 05/640/Do-421;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë për harmonizimin e rekomandimeve për petitionin kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike.

Komisioni unanimisht vendosi që pas pikës së 4 të shtohet edhe një pikë e rendit të ditës, pika 5. Harmonizimi i rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me petitionin e qytetarëve kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike, dhe pikat në vazhdim të radhiten sipas numrave me radhë.

Rendi i ditës u miratua me këtë plotësim.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve nr. 11 dhe nr. 12

Kryetarja- Tha se deputetja Teuta Haxhiu nuk është prezent për shkak të një rasti që e ka në familje, i është lutur që të kërkojë të bëhet ndryshimi në procesverbalin nr. 11, të rekomandimet për zbardhjen e Fatit të Ukshin Hotit, të fjalës së saj, propozoi që të rekomandimin e parë, të pjesa “në agjendën e bisedimeve në baza 6 (gjashtë) mujore”, të jetë që brenda 6 (gjashtë) muajve të jetë si temë në bisedimet me Serbinë, por jo në çdo 6 (gjashtë) muaj, fjala jo të hiqet dhe të jetë edhe në çdo 6 muaj.

- **Salihe Mustafa**, - Tha se ka vërejtje në procesverbalin nr. 11 që tregon se ka pasur një diskutim me deputeten Valdete Bajrami edhe pse ka qenë jashtë rendit të ditës, megjithatë është diskutuar në Komision, e që këtu nuk është përfshirë fare, por që kah fundi i procesverbalit është përmend fjalës së deputetes z. Bajrami, por pa e ditur më parë se çka është diskutuar. Pastaj të rekomandimet e petitionit për z. Ukshin Hotin, është rekomandimi nr. 3, edhe pse nuk i ka me vete rekomandimet që ia kanë dërguar stafi i Komisionit, por kërkon që ky rekomandim të jetë ashtu siç e kanë votuar në Komision dhe jo më këtë ndryshim pas votimit.

Mytaher Haskuka, - Po ashtu ka vërejtje në procesverbalin nr. 11 të dt. 15 prill 2015, në fjalën e tij që në mënyrë specifike të sigurohen mekanizma funksional për profesionalizimin e teknikave adekuate, duhej të ishte; të sigurohen mekanizma për funksionalizimin profesional dhe teknik të Departamentit i Mjekësisë Ligjore, dhe të sigurohet buxhet për punën e tyre. Ai tha se këto vërejtje do t'i paraqesë me shkrim para administratës sepse fjalës po duket e pakuptimtë.

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes nr. 11, i mbajtur me dt. 15 prill 2015, miratohet me këto vërejtje te anëtareve të Komisionit, ndërsa procesverbali i mbledhjes nr. 12 mbajtur me dt. 22 prill 2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Barazi Gjinore

Kryetarja fillimisht i përshëndeti përfaqësuesit e Qeverisë, përkatësisht Zyrës së Kryeministrit, z. Besim Kajtazi, drejtor i zyrës ligjore, që edhe do të prezantojë më konkretisht projektligjin pasi që edhe janë hartues në bashkëpunim me BE-në e shoqërinë civile.

Z. Besim Kajtazi- Tha se një nga prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës sipas tij kanë qenë krijimi i një kornize ligjore dhe avancimi i mbrojtjes dhe promovimit të drejtave të njeriut, që edhe brenda kësaj kohe ka rrjedhur procesi deri te miratimi i pakos së përbërë nga tri Projektligje; ai i Barazisë Gjinore, Mbrojtjes nga Diskriminimi dhe ai i Avokatit të Popullit, ndërsa për pjesën tjetër të vitit është në plan edhe një pako me një ndërlidhje të tillë, kjo tregon përkushtimin dhe krijimin e bazës ligjore për avancimin e të drejtave të njeriut nga ana e Qeverisë. Konsultimet kanë qenë të zgjeruara sa i përket procesit të hartimit të projektligjeve, përkatësisht atij të Barazisë Gjinore, duke filluar nga aktorët vendorë e deri te ata ndërkombëtarë, që kanë dhënë rekomandime, duke e përfshirë edhe kontributin e Këshillit Evropian dhe Komisionit Evropian me një projekt adekuat. Kanë krijuar ligjin e ri për Barazi Gjinore edhe pse është në fuqi ligji paraprak, nga arsyeja atë ligj kanë mundur të lexojnë vetëm juristët që e kanë njohur edhe legjislacionin vendor edhe atë të huaj, si dhe arsye tjetër ka qenë edhe harmonizimi me direktivat e BE-së dhe avancimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Pra qëllimi ka qenë që ligji të jetë sa më i kuptueshëm dhe sa më të zbatueshëm, i krijuar nga institucionet pa presione dhe është bërë më e mira.

Kryetarja- Tha se projektligji për Barazi Gjinore është me standarde dhe i bën më insistues për implementim, nëse nuk kanë pyetje ajo kërkon për procedim për lexim në parim të ligjit në Kuvend.

Kryetarja konstatoi se Komisioni unanimisht vendosi te nxjerr këtë:

R E K O M A N D I M

Kuvendi i Republikës së Kosovës ta miratojë në parim Projektligjin për Barazi Gjinore

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Kryetarja- Tha se edhe për këtë Projektligj hartues ka qenë zyra e Kryeministrit dhe për këtë prapë ja dha fjalën z. Kajtazi.

Besim Kajtazi –Tha se në lidhje me këtë ligj është bërë më e mundshme që të punohet sa më mirë dhe me ndryshime efikase, futja e disa instrumenteve në Ligjin për Mbrojtjen

nga Diskriminimi që si ndër vendet më të reja e në krahasim me disa vende që vetëm janë në diskutim, ka bërë që Kosova të jetë në avancim në këtë drejtim. Andaj qëllimi i kësaj pakos nuk është të jetë për një kohë të shkurtër, por për një periudhë më të gjatë për zbatim. Po ashtu është realizuar me direktiva të BE-së me veprimin apo jo të institucioneve vendore, personave fizikë dhe juridikë të sektorit privat dhe publik. Në këto ligje nuk janë krijuar mekanizma të rinj për shkak të kostove, edhe pse konsiderohet një procedurë më e lehtë për hartuesin e ligjit. Zgjedhja e procedurave gjyqësore dhe kontesteve më procedura ndërmjetësuese më një periudhë të caktuar, kanë qenë të nevojshme që Qeveria është duke përgatitur strategjinë për të drejtat e njeriut, në mënyrë të zbatimi të këtij ligji dhe promovimin e tij në vend.

Edona Tolaj- Tha se kanë paraqitur disa rekomandime për mbrojtjen nga diskriminimi dhe përkrahin projektligjin në parim. Hulumtimin që kanë realizuar tregohet se nuk ka qenë shumë i zbatueshëm ky ligj, dhe plotësim ndryshimi ka qenë i nevojshëm, dhe kërkohet konkretizim dhe sqarimi i procedurave kundër diskriminimit.

Kryetarja- Tha se në të tri ligjet kemi disa vërejtje, pikërisht të problemet që dalin gjatë implementimit, sepse është thirrur që janë me standarde të larta, ndërsa standardi jo i lartë i shoqërisë po bën që ato të mos jenë shumë të zbatueshme, ndërsa studimet që bëhen në këtë rast, si kjo e Nismës i bëjnë të gjejmë edhe defektet se pse nuk po shkon mirë me diçka për një kohë të caktuar. Pa dashur të vazhdojë tutje, tregon se ky ligj synon ato standarde dhe respekton ato konventa që veç janë krijuar nga kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe që nuk po gjenden vërejtje dhe pyet deputetët për gjërat e paqarta që kanë.

Mytaher Haskuka- Në lidhje me raportet për përputhshmëri me Bashkimin Evropian dhe dokumentet, a ka pasur gjatë procesit të përpilimit të ndryshimeve të ligjit, konsultime me shoqërinë civile, dëgjime publike në aspektin e procesit edhe për ligjin e Barazisë Gjinore, po ashtu edhe për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi?

Z. Besim Kajtazi- Flet më një përgjegjësi të plotë së pakoja e këtyre ligjeve duhet të merret edhe shembull për vendet tjera, kanë pasur një varg të konsultimeve në nivele komunale në të 6 rajonet e Kosovës, qoftë me punonjësit po ashtu edhe me shoqëritë civile, nga mediat po ashtu, duke shkuar në nivel qendror për konsultime, si dhe me institucionet ndërkombëtare, Komisionin Evropian, OSBE-në si përkrahësi dhe një numër i madh i organizatave të ndryshme. Pastaj para fillimit të hartimit janë analizuar edhe hulumtimet e raportet që janë bërë për këto ligje duke e përfshirë edhe këtë studim që kanë prezent deputetët. Këshilli Evropian dhe Komisioni i Evropës kanë pasur një projekt të përbashkët, që kanë bërë një raport të thuktë lidhur me gjithë procesin dhe avancimin e të drejtave të njeriut, dhe në këtë raport i japin rekomandimet për secilin nga ligjet e kësaj pakoje, më një debatim është arritur që këto të jenë të zbatueshme dhe në të mirë të kualitetit.

Mexhide Topalli - Mjaku- Duke diskutuar rreth përmbajtjes së projektligjit kundër diskriminimit i përmendi disa gabime gjuhësore te paragrafi i dytë që duhet të përmirësohen. Po ashtu ajo përmendi edhe disa gabime ose mospërputhje gjuhësore në

mes versioneve të projektligjit në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze. Ajo kishte vërejtje edhe te neni 7.1 i projektligjit sipas së cilës fjalia është e pakuptimtë dhe duhet të intervenohet në mënyrë që të bëhet me kuptueshme.

Kryetarja duke diskutuar rreth projektligjit përmendi edhe deklaratimet e përfaqësuesve të ministrisë, të cilët kanë deklaruar se kanë tentuar t'i ikin implikimeve buxhetore, mirëpo kjo do të sqarohet në të ardhmen.

Kryetarja konstatoi se Komisioni me vota unanime vendosi të nxjerrë këtë:

REKOMANDIM

Kuvendi i Republikës së Kosovës ta miratojë në parim Projektligjin kundër Diskriminimit

5. Harmonizimi i rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me petitionin e qytetarëve kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike

Kryetarja – I informoi anëtarët e Komisionit se e kanë tekstin me rekomandime dhe i ftoi ata që të japin propozimet e tyre lidhur me këtë në mënyrë që të bëhet harmonizimi i rekomandimeve. Ajo e theksoi se është vënë edhe njëherë në rend dite kjo çështje me qëllim të evitimit të çfarëdo lloj shtyrje tjetër që ka të bëjë me këtë çështje. Lidhur me përmbajtjen e rekomandimeve ajo tha se rekomandimi i parë shkon rekomandimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe e lexoi rekomandimin nga shkresa e më parme të cilën e ka miratuar Komisioni. Në vazhdim, si rekomandim nr 2, ajo tha se shkon rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa duke e lexuar nga shkresa e miratuar nga Komisioni për Buxhet, e që kishte të bënte me procedimit sa më të shpejtë nga Qeveria të projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03 / L – 146 për tatimin në vlerën e shtuar, dhe propozohet zbritja e TVSH-së në konsumin e energjisë elektrike nga 16% në 8%. Po ashtu edhe rekomandimi 3 shkon nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, sepse ka implikime buxhetore lidhur me kategorinë sociale. Sipas këtij rekomandimi, Qeveria duhet të rishikojë listën e përfituesve të kategorisë sociale, dhe të identifikohen përfituesit që kanë ndryshuar statusin financiar në mënyrë që të bëhet shpërndarja e mjeteve buxhetore për familjet që kanë nevojë. Ndërsa lidhur me rekomandimin e fundit kryetarja tha se do të mbetet ai i njëjti edhe pse kanë marrë vërejtje nga Kryesia që ka të bëjë me kërkesën për mos rritjen e energjisë elektrike, deri në kohën e rishikimit të buxhetit për vitin 2015.

Valdete Bajrami – Duke u ndërlidhur me rekomandimet theksoi se në takimin e kaluar janë akorduar që si pjesë e rekomandimeve të jenë edhe obligimi i Rregullatorit që t'i shqyrtoj të gjitha ankesat e qytetarëve që janë paraqitur në petition.

Mytaher Haskuka- Kërkoi sqarime rreth rekomandimeve sepse ai theksoi se më parë i kanë miratuar rekomandimet dhe pse duhet që sërish t'i miratojnë.

Kryetarja e informoi anëtarin e Komisionit se tani bëhet harmonizimi i rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Komisionit për Buxhet.

Mytaher Haskuka- Ishte i mendimit që kërkesat e peticionit të KOSID-it përcillen ashtu si janë në Kuvend dhe atje të diskutohet dhe të vendoset se cilat nga rekomandimet të miratohen.

Kryetarja – I bëri të ditur se nëse shkojnë në seancë me dy dokumente ka gjasë që sërish të shtyhen për ndonjë takim të radhës dhe nuk është e arsyeshme që të zvarritet kohë pa nevojë.

Mytaher Haskuka- Kërkoi që si rekomandim të jetë edhe diskutimi i kërkesave të qytetarëve që janë paraqitur në peticion.

Valdete Bajrami – Duke u ndërlidhur me parafolësin e theksoi se në pikën e parë janë akorduar që të debatohet për kërkesat e paraqitura në peticion.

Etem Arifi- Duke u bashkangjitur theksoi se te rekomandimi i parë, ku flitet për raportin e veçantë për të gjitha çështjet e ngritura në peticion, të Rregullatorit, atyre nuk ua ndalon askush që të diskutojnë për çështjet që janë me rëndësi për rata e që nuk janë marrë parasysh në raport.

Kryetarja – Pas këtyre diskutimeve i ftoi për votim të rekomandimeve të harmonizuara në mes të dy komisioneve.

Me 6 vota pro dhe 1 abstenim miratohen rekomandimet e harmonizuara lidhur me Peticionin e qytetarëve kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike.

6. Shqyrtimi i peticionit nr 05/640/do/421

Kryetarja – Duke dashur që të jenë më efikas dhe për të mos e angazhuar të gjithë përbërjen e Komisionit, ai propozoi që të caktohen tre anëtarë që të merren me këtë çështje dhe pastaj të prezantojnë para Komisionit. Ajo theksoi se është konsultuar me znj. Teuta Haxhiu që të jetë anëtare e këtij grupi, si dhe Etem Arifi dhe Valdete Bajrami. Ajo e arsyetoi këtë grupim duke marrë parasysh faktin se Komisioni ka angazhime të shumta dhe është e nevojshme që me grupime t'i ndajnë punët në mënyrë që të jenë më efikas.

Valdete Bajrami – Kërkoi sqarime rreth caktimit të agjendës për shqyrtimin e këtij peticioni.

Pas këtyre diskutimeve Komisioni vendosi të nxjerrë këtë:

Përfundim

Grupi punues për shqyrtimin e petitionit nr. 05/640/do/421, do të jetë në këtë përbërje: Teuta Haxhiu, Etem Arifi dhe Valdete Bajrami.

7. Të ndryshme

Kryetarja- Tha se sa u përket vizitave nëpër njësit komunale për të drejtat e njeriut deputeti Kujtim Pacaku, ka bërë një agjendë dhe lus deputetin Pacaku të merr fjalën.

Kujtim Pacaku- Tha se në takimet e mëparshme kemi bërë diskutime për të vizituar disa njësi komunale për të parë si po behet organizimi dhe funksionalizimi i komiteteve për komunitete dhe zyrave për komunitete, kemi bërë një agjendë të vizitave me administratën, kemi propozuar vendet por jo datën dhe orën, për këto do të vendosim bashkërisht si Komision.

Salihe Mustafa- Propozoi, meqenëse është paraparë vizita për monitorimin e ligjit për personat e verbër në Pejë, atëherë mundemi po në të njëjtën ditë me bërë edhe vizitën në njësitin e të drejtave të njeriut në këtë komunë, pra të dy vizitat të realizohen në të njëjtën ditë pasi që është i njëjti vend. Tha se është kërkesë që vizita e parë për këtë qëllim të realizohet në Pejë.

Kryetarja- Tha se përveç atyre komunave që janë parapa në agjendë për vizitë, propozoi edhe Podujevën, dhe mundësisht brenda ditës të vizitohen nga dy komuna, të shfrytëzohet e njëjta vijë, p.sh. në të njëjtën ditë Graçanicë, Gjilan, Podujevë e Mitrovicë.

Ajo po ashtu njoftoj se shoqata për rehabilitim të viktimave të torturës ka në plan ta bëjë një punëtori në Shqipëri, si orientim kanë kërkuar datat 23 dhe 24 maj, së bashku me dy komisionet, atë për legjislacion dhe komisionin tonë, dëshirojnë të jetë komplet spektri politik i përfshirë, ku do të diskutohet për mekanizmin e torturës për Projektligjin për Avokatin e Popullit. Ajo tha se këto janë data orientuese, dhe kur të kemi ftesën finale do tua përcjellim të gjithëve.

Kryetarja -Tha se kemi propozimin e OSBES-së për takim me shefin e misionit të OSBE-së në Kosovë.

U propozua që me 11 maj, në orën 12 të jetë takimi i Shefit të Misionit të OSBES-së në Kosovë me kryetaren e Komisionit, në orën 12:30, takimi me komisionin dhe nëse do të këtë mbledhje të rregullt të komisionit të vazhdohet prej orës 13.00.

Lejla Selimi- Tha se OSBE, ka mundësi me mbështet një dëgjim publik, lidhur me ligjin për Avokatin e Popullit, po ashtu kemi mundësi me mbështet edhe një vizite jashtë Prishtinës.

Kryetarja lidhur me ditën e personave të pagjetur në Kosovë tha se punët nuk kanë qenë të bashkërenduara si duhet, por duhet të punojmë më shumë, ashtu si kërkuan edhe familjarët edhe në amendamentimin e ligjit për personat e zhdukur.

Mexhide Mjaku-Topalli- Lidhur me shënimin e javës së personave të zhdukur, punët nuk kanë qenë të radhitura si duhet dhe ne, si Komision, nuk kemi dalë mirë, kemi hyrë në seancë se kemi ditur kush do të flasë në emër të Komisionit, është mirë me ditur ku ka qenë problemi, e kam ndier veten keq, kur është bërë zbulimi i obeliskut për personat e zhdukur dhe ne, si Komision, është dashur me një buçet lule me bërë një nderim për ata persona para atij obelisku, mbetem vetëm si shikues. Besoj se do të vazhdojmë të punojmë edhe me tutje për fatin e personave të zhdukur dhe të punohet që personat që kanë kryer këto krime të dalin para drejtësisë, kemi shumë punë për të bërë në këtë drejtim, por të organizohemi më mirë.

Kryetarja - Tha se në mënyrë faktike nuk kemi qenë të kyçur në organizime, po përmes shkresave del se ka qenë edhe organizim i Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Lirije Kajtazi